

# NJOHJA ME KODIN E IESBA-së

## Pjesa 3: Kuadri Konceptual – Hapi 2, Vlerësimi i Kërcënimeve



Profesionistët kontabël udhëhiqen nga parime themelore që i ndihmojnë ata të mbajnë përgjegjësinë e tyre për të vepruar në interes të publikut. Çdo kërcënim për pajtueshmërinë me parimet themelore duhet të vlerësohet. Duke vepruar kështu, profesionistëve kontabël u kërkohet të përdorin **testin e palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme** në përcaktimin nëse një kërcënim është në një nivel të pranueshëm.

Në pjesën 2, ne shqyrtuam sesi profesionistët kontabël duhet të identifikojnë fillimisht kërcënimet – Interesin Vetjak, Vetë-rishikimin, Favorizimin, Familiaritetin, Frikësimin –që mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të vepruar në pajtueshmëri me parimet themelore. Hapi i rradhës është të vlerësojmë nëse kërcënimet e identifikuar janë në një **nivel të pranueshëm**.



Profesionistët kontabël duhet të përdorin **testin e palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme** për të vlerësuar çfarë përfundimi mund të arrije një palë e tretë në lidhje me nëse dhe në çfarë mase, ekziston një kërcënim.

Pala e tretë e arsyeshme dhe e besueshme është dikush që mund të mos jetë një profesionist kontabël por ka njohuri dhe eksperiencë për të kuptuar faktet dhe rrethanat e rëndësishme dhe të vlerësojë në mënyrë të paanshme përshtatshmërinë e vendimeve dhe konkluzioneve të profesionistit kontabël.

**Vlerësimi i kërcënimeve:** Le të përdorim testin e palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme për të vlerësuar kërcënimet e identifikuar nga Drejtuesi i Politikës Kontabël, i cili punon për një kompani ndërkombëtare prodhuese.

CEO ka një plan për të nisur veprimtarinë në një treg në zhvillim. Si Drejtues i Politikës Kontabël, ju nuk jeni të sigurtë që plani është në pajtueshmëri me ligjet për korrupsionin dhe ryshfetet.

Kompania së fundmi ka humbur pjesën e tregut dhe aksionet kanë humbur 10% të vlerës së tyre të tregut. Një plan i ri i besueshëm për hyrjen në një treg me një marzh fitimi të lartë do të kënaqë Bordin e Drejtuesve dhe aksionerët. CEO gjithashtu ka premtuar shpërblime të konsiderueshme nëse ekipi do të "kryejë punën, me çdo kusht".

Ju keni rishikuar komunikimet me email - disa prej të cilave tregojnë se mjetet monetare janë transferuar në llogaritë bankare të vendeve të synuara rreth së njëjtës kohë që plani i ri i biznesit ishte duke u hartuar.

## Drejtuesi mund të tundohet për të përdorur arsyetimin e mëposhtëm:

"Praktikat e pranueshme të biznesit ndryshojnë midis vendeve dhe ato që nuk mund të lejohen në vendin tim, mund të lejohen (ose janë të domosdoshme) në tregjet e tjera."

**Qasja e drejtuesit ndryshon** kur konsiderohet perspektiva e paanshme e një pale të tretë të arsyeshme dhe të besueshme. Duke përdorur këtë perspektivë, drejtuesi **do të vlerësojë llojet e kërcënimeve dhe do të arrijë në konkluzionet e mëposhtme:**

**1 EGOIZMI (INTERESI VETJAK)** – Premtimi i shpërblimeve të mëdha mund ta bëjë Drejtuesin të hezitojë për të investiguar emailt e zbuluara, më pak objektiv në vlerësimin e situatës ose më pak të kujdesshëm për të kuptuar ligjet kundër ryshfetit.

✓ Kërcënimi i interesit vetjak ndaj integritetit, objektivitetit, kompetencës profesionale, kujdesit të duhur dhe sjelljes profesionale **nuk është në një nivel të pranueshëm.**

**2 VETË-RISHIKIMI** – Drejtuesi nuk ishte përfshirë në hartimin e planit, kështu që ekziston shumë pak kërcënim që ai të vlerësojë punën/analizën e tij.

✓ Kërcënimi i vetë-rishikimit është **në një nivel të pranueshëm.**

**3 FAVORIZIMI (PËRKRAHJA)** - Drejtuesi nuk është duke u vendosur në një pozicion në të cilin favorizon ose përkrah pozicionin e kompanisë. Ky kërcënim mund të bëhet më domethënës nëse Drejtuesit i kërkohet më pas të "shesë" planin tek aksionerët ose "të mbrojnë" planin tek autoritetet tatimore.

✓ Kërcënimi i favorizimit është **në një nivel të pranueshëm.**

**4 FAMILIARITETI** – Drejtuesi mund të jetë "shumë afër" me situatën dhe i prirur të pajtohet me planin e CEO-s nga besimi i patundur tek CEO-s dhe tek procesi i vendimmarrjes së kompanisë.

✓ Kërcënimi i familjaritetit ndaj integritetit, objektivitetit, kompetencës profesionale, kujdesit të duhur dhe sjelljes profesionale **nuk është në një nivel të pranueshëm.**

**5 FRIKËSIMI** – Qasja "me çdo kusht" e CEO-s mund të shtyjë Drejtuesin të gjejë përgjigjen "e saktë" dhe të aprovojë planin sepse puna dhe reputacioni janë në një linjë.

✓ Kërcënimi i frikësimit ndaj integritetit, objektivitetit, kompetencës profesionale, kujdesit të duhur dhe sjelljes profesionale **nuk është në një nivel të pranueshëm.**

**Adresimi i kërcënimeve:** Në pjesën tjetër të *Njohjes me Kodin e IESBA-së*, ne do të mësojmë sesi Drejtuesi adreson kërcënimet që nuk janë në një nivel të pranueshëm.

## KU MUND TË GJENDET INFORMACIONI I NEVOJSHËM?



Testi i palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme mund të gjendet në paragrafin 120.5 A4 të Kodit. Kuadri konceptual është paraqitur në Pjesën 1, Seksioni 120 i Kodit. Dispozitat shtesë që janë të rëndësishme në zbatimin e këtij kuadri janë paraqitur në Pjesët 2, 3, 4A dhe 4B, respektivisht në Seksionet 200, 300, 400 dhe 900.



ECode, i cili është i disponueshëm në [www.IESBAeCode.org](http://www.IESBAeCode.org), është një burim online për profesionistët kontabël dhe përdoruesit e tjerë të Kodit. Ai siguron akses të shpejtë dhe eficient në Kod, duke bërë atë më të lehtë për tu përdorur, implementuar dhe zbatuar.

“Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 3: Kuadri Konceptual - Hapi 2, Vlerësimi i Kërcënimeve”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Shkurt 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 3: Kuadri Konceptual - Hapi 2, Vlerësimi i Kërcënimeve” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 3: Kuadri Konceptual - Hapi 2, Vlerësimi i Kërcënimeve” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Exploring the IESBA Code Installment 3 – The Conceptual Framework , Step 2, Evaluating Threats”

Kontakttoni [Permissions@ifac.org](mailto:Permissions@ifac.org) për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.